



Planuar / Dërguar Priljena/Prodato Received/Delivered	08 - 03 2023	viti год year	3
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHICK	2504/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.176/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-ne cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër AA.nr.354/22, të datës 17.01.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.684/2019 të datës të datës 06.11.2019, të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit, Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensimi material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 07.03.2023, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 684/2019 e datës 06.11.2019, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 418/19-02, i datës 27.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datën 12.04.2019 ka nxjerr vendim, me numër të protokollit Nr.-02 2068 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës për nëpunësen civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin e datës 12.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Regjistrimit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me datën 26.04.2019, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë së Punëve të Brendshme me datë 27.05.2019, ka nxjerr vendim me numër të protokollit 418/2019-02 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuseses si të pa bazuar në ligj.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin me numër 418/2019-2, të datës 27.05.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 06.11.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 5211/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të ankuseses duhet ti bëjë pagesën e dy (2) pagave, pas arritjes së moshës së pensionimit si dhe kompensimin e dy (2) pagave jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesën e ankuseses e ka proceduar tek Ministria e Punëve të Brendshme, për përgjigje në ankesë me datë 08.11.2019, ndërsa me datën 18.11.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me provat e bashkangjitura .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuseses, ndërsa me datën 27.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke e udhëzuar se mund ti ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund ta filloj procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020 ka qenë jo funksional, ndërsa pas zgjedhjes së pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, shqyrtimit të bazës ligjore, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës në mbledhjen e katërt të mbajtur me datën 09.11.2020 nxjerr Vendim me Nr. 09/2020 me të cilën është vendosur që të gjitha ankesat e dorëzuara dhe ato të kthyera në rishqyrtim nga gjykata do të vendosen nga Këshilli.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të ankesës së datës 06.11.2019 , me datën 14.12.2020, ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.684/2019 sipas të cilit ka refuzuar si të papabazuar ankesën e ankuseses. Ndërsa e njëjta kundër vendimit me numër A.nr.684/2019 të datës 14.12.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykate Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.3115/19 i cili në Këshill është pranuar me datën 28.02.2022, sipas

të cilit e ka anuluar vendimin e këshillit dhe e ka kthyer çështjen e ankuesit në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 15.03.2022 ka parashtruar Ankesën me numër A.nr.3115/19 pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ndërsa kjo e fundit me datën 17.01.2023 ka nxjerr Aktgjykimin nën shenjën AA.nr.354/2022 e cila në Këshilli është pranuar me datën 08.02.2023, sipas të cilit ka refuzuar ankesën e Këshillit dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative.

Administrimi i Provave: Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin nën shenjën Aa.nr.354/2022 të datës 08.02.2023 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë; Ankesën me numër A.nr.3115/2019 të datës 15.03.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë; Aktgjykimin me numër A.nr.3115/2019 të datës 14.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigjen në padi me numër të protokollit 3951/2021 të datës 28.07.2021; Aktvendimin me numër A.nr.3115/2019 të datës 21.07.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative; Padinë e datës 27.12.2019 ; Njoftimin me numër të protokollit 5618/2019 të datës 27.11.2019; Vendimin me numër të protokollit 2068 të datës 12.04.2019 për pensionimin e nëpunëses civile; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Plotësimin e padisë të datës 14.07.2021; Plotësimin e padisë të datës 26.12.2019; Vendimin me Nr.18/2021 të datës 07.07.2021 për lejimin e qasjes në dokumente publike; Vendimin me numër A.nr.684/2019 të datës 14.12.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.21/2019 të datës 24.05.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ankesën e datës 06.11.2019 të parashtruar nga ankuesja tek Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshëm; Kërkesën e datës 24.04.2019 për pagesën e dy pagave mujore dhe dy pagave jubilarë me rastin e shkuarjes në pension; Ankesën me numër të protokollit 5211/2019 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5296/2019 të datës 08.11. 2019; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5387/2023 të datës 18.11.2023; Akt-in e emërimit me shenjën SRAPSH/ARC-21/13 të datës 31.01.2013; Njoftimin e datës 04.10.2018 për ndërprerje të marrëdhënies së punese së nëpunëses; Listën e pagave për muajin Prill-2019; Listën e pagave për muajin Dhjetore-2013; Njoftimin me numër të protokollit 5618/2019 të datës 27.11.2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar sepse:*

Sipas Aktgjykimit A.nr.3115/19 të datës 14.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative në të cilin është theksuar se nuk janë shqyrtuar pretendimet e ankueses, sipas kërkesës se saj respektivisht kompensimin e pagave jubilarë, ku është bërë edhe konstatimi i gabuar lidhur e datën e saktë të pensionimit të ankueses. Këshilli pas rishqyrtimit të ankesës sipas aktgjykimit të lartë përmendur ka konstatuar se ankuesja sipas vendimit me numër 2068 të datës 12.04.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm në ARC-së me datën 08.04.2019 i është ndërprerë



marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit përmes të cilit i është njohur edhe kompensimi i një page përcjellëse në vlerën e pagës së fundit.

Tutje Kolegji i Këshillit pas analizimit të Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 14.02.2022 e cila ka obliguar Këshillin që konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duhet që të shqyrtoj përsëri ankesën e ankueses vetëm sa i përket kërkesës se kompensimit të pagave jubilarë por jo edhe pretendimet tjera. Andaj pas analizimit të pretendimit lidhur me kompensimin e dy pagave jubilarë siç kërkon ankuesja në ankesën e datës 06.11.2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës e cila duke u bazuar në nenin 52 të Marrëveshjes Kolektive të Kosovës kërkon kompensimin e dy (2) paga jubilarë, e cila përcakton se; *i punësuari, ka të drejtë në shpërblinin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij*, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ky pretendim është i pa bazuar sepse të njëjtës sipas dëshmisë respektivisht listës se pagave të datës 31.12.2013 i është kompensuar paga jubilarë në vlerë prej 82.00 euro, ashtu siç është paraparë edhe në nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për pagat e Nëpunësve Civil ndërsa me datën 08.04.2019 ankuesja është pensionuar dhe se nuk ka arritur dhjetë(10) vjetorin për t'ju kompensuar edhe një pagë jubilarë pasi që ankuesja për të marr edhe një pagë jubilarë është dashur të jetë në marrëdhënie punë deri në vitin 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës"*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *"Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit"*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankueses me rastin e pensionimit, të njëjtës i ka përfunduar marrëdhënia e punës sipas Vendimit të datës 12.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme, në rastin e marrjes së vendimit pas moshës së pensionimit si dhe kompensimin e një pagë pas moshës së pensionimit, për nëpunëses civil është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është marrë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr.176/2022

Ilire MEHMETI-SHAQIRI



Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative;
- Arkivit të KPMSHCK-së

